



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministry of lokal government Administration

Duke u bazuar në Ligjin NR. 03/L - 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal shpallë këtë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar i Lartë për Zhvillim dhe Monitorim të Projekteve
Departamenti:	Departamenti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal
Divizioni:	Zhvillim dhe Monitorim të Zbatimit të Projekteve
Orari i punës:	Orar i plotë i punës
Koeficienti:	8
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit
Lloji i pozitës:	Karrierës
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Referenca:	MPL/130

Qëllimi i vendit të punës:
Zhvillimi i projekteve të MAPL-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Përgjegjës për zhvillimin e projekteve ne përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;
2. Vlerëson, përcjell dhe identifikon nevojat kyçe të MAPL-së për kontratat afatgjatë përfshirë specifikën, përvetësimin, mirëmbajtjen dhe kërkesat e mbështetjes;
3. Përgatitja e projekteve për investime publike të MAPL-së;
4. Ndihton në menaxhimin e kontakteve ne përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;
5. Monitorimi i realizimit të projekteve ne komuna dhe ne MAPL;
6. Punon me furnizuesit dhe shërbyesit dhe siguron mbarëvajtjen e marrëdhënieve dhe shërben si pikë kontaktuese e autorizuar për të gjitha çështjet e kontratës;
7. Përgatitja e raporteve periodike të punës;
8. Detyra tjera siç kërkohen nga Udhëheqësi i divizionit.

Kualifikimi dhe përvoja:

Diplomë universitare në teknik, dega e elektroteknikës ose ndërtimtarisë;

Së paku 3 vite përvojë pune.

- Aftësi në menaxhimin dhe vlerësimin e projekteve kapitale;
- Aftësi në mbikëqyrjen e projekteve të komunave;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi (të shkrimit dhe atij gojor)
- Të jetë kreativ dhe me vëmendje në detaje;
- Të jetë komunikativ, i vetëpërmbajtur dhe të jetë i aftë që të menaxhoj me kohën dhe punët;
- Përveç gjuhëve zyrtare të Kosovës është përparësi njohja e gjuhës angleze.
- Të ketë njohuri në Microsoft Office package, dhe programet qe kane të bëjnë me CAD/CAM.

Aktet ligjore dhe aktet nën –ligjore që rregullojnë rekrutimin

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149 Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil .

Kohëzgjatja e emërimit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit është në përputhje me LSHCK Nr. 03/L-149, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese njëvjeqare.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formularët zyrtar për aplikim merren në Zyrën e Personelit të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203 , ndërtesa e ish-Rilindja, gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga ueb -Faqja e MAPL -së.

Kushtet per pjesëmarrje ne rekrutim

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj, mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës.

-“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”,

-“Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11,pragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikë së Kosovës”

-Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

-Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Procedura e Konkurimit

Procedura e konkurimit është e jashtme dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në ueb-Faqen e Ministrisë:

mapl.rks-gov.net

Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: 038-200 35-568.